

RREGULLORE E PËRGJITHSHME E KAMPIONATIT "ENDURO"

1. Të përgjithshme

- 1.1 Bike Club Tirana organizon Kampionatin "Albania Enduro Series" (AES).
- 1.2 Kampionati në edicionin 2017 do të përbëhet nga pesë gara.
- 1.3 Çdo garë ka sistem pikësh. Çiklisti **Kampion "AES 2017"** do të shpallet nga shuma e pikëve të marra në garat që ka marrë pjesë.
- 1.4 Pjesëmarrja në AES është e hapur për çiklistët amatorë dhe profesionistë.

2. Klasat

- 2.1 Klasat e pjesëmarrësve do të jenë katër.

Meshkuj

Under 20

16-20 vjeç (të lindur nga 1 janari 1997 deri në 31 dhjetor 2001)

Elite

21-40 (të lindur nga 31 dhjetor 1996 deri në 1 janar 1977)

Master

40+ (të lindur para 1 janar 1977)

Femra

17+ (të lindur para 1 janari 2001)

3. Çiklistët

- 3.1 Albania Enduro Series, është e hapur për çiklistët amatorë dhe profesionistë, me moshë mbi **16 vjeç (të lindur para 1 janar 2002)**.
- 3.2 Çdo pilot e ka të detyruar veshjen mbrojtëse minimale: Helmetë , mbrojtëse për sytë, doreza, gjunjëza.

4. Biçikleta

- 4.1 Gara "ENDURO" EN, është një garë me biçikleta mountain bike.
- 4.2 Zgjedhja e biçikletës me të cilën mund të merret pjesë është në vullnetin e garuesit.
- 4.3 Nuk do të ketë ndarje sipas tipologjisë së saj.
- 4.4 Fuqia shtytëse e biçikletës duhet të jetë vetëm nëpërmjet fuqisë fizike të sportistit.
- 4.5 Nuk lejohet ndërrimi i biçikletës gjatë garës.

5. Numrat e garës

- 5.1 Numri i garës është unik dhe i njëjtë për të gjithë kampionatin.
- 5.2 Çdo garues do pajiset me dy numra ngjitur që duhen vendosur në biçikletë.
- 5.1 Njëri numër vendoset në pjesën ballore të bicikletës ndërsa numri tjetër në tubin e sipërm të bicikletës pranë qafës së timonit.

6. Navigacioni

6.1 Në Kampionatin AES-2017 navigacioni do të jetë vetëm me GPS.

6.2 Një file në formatin **.gpx** do t'u dërgohet garuesve të regjistruar në garë, me email në orën 19:00 të ditës së fundit para garës.

7. Formula e garës

7.1 Trajektorja do të jetë e ndarë në disa sektorë: Sektorë Lidhës (LS) dhe Sektorë Specialë (SS)

7.2 Në LS, çiklisti duhet të ndjekë trajektoren me një shpejtësi mesatare të caktuar dhe brenda një kohe fikse të përcaktuar, që do të quhet Target Time (TT). Në LS çiklisti duhet të mbërrijë në Check Point (CP) brenda kohës së paracaktuar TT.

Për çdo LS do të jepet një kohë TT. Në SS çiklisti duhet të ngasë biçikletën sa më shpejt të jetë e mundur.

7.3 Koha e një SS është koha nga starti i Sektorit deri në finish të Sektorit.

Shuma e kohëve të të gjitha SS-ve të trajektores përbën kohën e garës dhe përcakton fituesin.

Koha më e vogël fiton. (në kohën e garës shtohen edhe penalltitë që çiklisti mund të ketë marrë). Mbërritja me vonesë do të mblidhet me kohën e garës. Një sekondë për çdo sekondë vonesë. Nuk lejohet nisja e SS përpara orës së paracaktuar.

7.4 Gara është me nisje individuale; çdo minutë të plotë.

Rradha e nisjes në Garën e parë do të bëhet me short.

Sipas klaseve: Under 20 / Elite / Master / Femra

Në raundet e tjera do të bëhet sipas renditjes provizore të Kampionatit.

Vendi i fundit në klas niset i pari, i parafundit niset i dyti,... e me rradhë.

8. Pikët

8.1 Që të marrësh minimalisht një pikë duhet të kalosh vijën e startit.

8.2 Shkallëzimi i pikëve për çdo garë do të jetë:

Vendi	Pikët
1	30
2	25
3	22
4	18
5	16
6	15
7	14
8	13
9	12
10	11
11	10
12	9
13	8
14	7
15	6

Vendi	Pikët
16	5
17	4
18	3
19	2
20	1
21	1
22	1
23	1
24	1
25	1
26	1
27	1
28	1
29	1
30	1

8.3 Do të ketë fituesë për çdo klas.

9. Regjistrimet

9.1 Regjistrimi për çdo garë është i veçantë.

9.2 Afati i fundit për regjistrim është **48 orë** përpara fillimit të garës.

9.3 Numri maksimal i pilotëve në garë është **50** pilotë.

9.4 Në oraret e kontrollit administrativ, të gjithë pilotët duhet të paraqiten dhe të sjellin dokumentet e kërkuara specifikisht për çdo garë.

9.5 Mosparaqitja në këto orare përbën skualifikim nga gara.

10. Gjyqtaria

10.1 Gjyqtaria e garës përbëhet nga:

10.2 Drejtuesi i eventit

10.3 Drejtuesi i garës.

10.4 Juria sportive e kohëmatjes, numërimit dhe vendimarrjes.

10.5 Komisarët e pistës

10.6 Kujdestarët e pistës

10.7 Mjeku i garës

11. Protestat

11.1 Çdo çiklist që ka një protestë, duhet ta depozitojë atë me shkrim menjëherë pranë jurisë.

11.2 Brenda 30 minutash nga depozitimi i kërkesës Juria do të japë përgjigjen.

11.3 Limiti kohor i ankesave është jo më vonë se 30 minuta pas publikimit të rezultatit final.

3. Trajektorja e garës

Trajektorja e garës do të jepet një ditë para garës, në orën 19:00 me email për të gjithë garuesit.

Formati i trajektores do të jetë .GPX

4. Penalltitë Sportive

Penalltitë sportive do të publikohen 7 ditë përpara garës.

1. Trofeu Albania Enduro Series do të përbëhet nga pesë gara.

2. Secila garë do të ketë një sistem pikësh.

3. Shuma e pikëve të të treja garave do të përcaktojë fituesin.

4. Në rast pikësh të barabarta, fiton çiklisti me më shumë vende të para. Në rast

barazimi edhe këtu, numërohen vendet e dyta e me rradhë.

5. Sistemi i pikëve në garë është:

Vendi 1: 30 pikë

Vendi 2: 25 pikë

Vendi 3: 22 pikë

Vendi 4: 20 pikë

Vendi 5: 18 pikë

Vendi 6: 16 pikë

Vendi 7: 15 pikë

dhe vazhdon me nga një pikë më pak deri në fund.

6. Vendi i parë i përgjithshëm fiton një çmim monetar.

Fituesi i këtij çmimi shpallet garuesi që ka më shumë pikë në total dhe njekohësisht ka marrë

pjesë në të pesta garat e Trofeut.

7. Për t'u kualifikuar për të marrë pikë në një garë duhet të kesh mbërritur minimumi deri në CP3.